

VENDIM
Nr. 247, datë 29.3.2017

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË POGRADEDEC, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË, TË PASURISË ME NR. 77, NË ZONËN KADASTRALE 2420, ME SIPËRFAQE 5 900 m² DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 417, DATË 8.6.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS ÇËRRAVË, TË QARKUT TË KORÇËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “e”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 417, datë 8.6.2011, të Këshillit të Ministrave, kudo, në titull dhe në përmbajtjen e vendimit, fjalët “...të Komunës Çërravë...” zëvendësohen me “...në njësinë administrative Çërravë, Bashkia Pogradec...”.

2. Transferimin në pronësi të Bashkisë Pogradec, në njësinë administrative Çërravë, të pasurisë me nr. 77, e ndodhur në zonën kadastrale 2420, me sipërfaqe 5 900 (pesë mijë e nëntëqind) m², sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim ndërtimin e stacionit të transferimit të mbetjeve të ngurta.

3. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 417, datë 8.6.2011, të Këshillit të Ministrave, të shtohet prona e përmendur në pikën 2.


4. Bashkisë Pogradec i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryetari i Bashkisë Pogradec dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi


PLAN VENDOSJE




SH.1.2500

POZICIONI NE PASTE I PASURISE .77

K-34-114-(103-D)



- Pronari: Shtet. (ish N. B)
 - Zona Kadastrale: 2420
 - Numri Pasurisë: 77
 - Adresa: Fshati Feshnicë,
 - Nj. A. Çerçave Bashkia Pogradec.
 - Vol. Fshe.
 - Sipërfaqja: 6.1 ha.
 - Indeksi Hartës: K-34-114-(103-D)
 - Data: 09.11.2016.
 - Kategoritë e Tokës: VIII-ë.
 - Zoti Kadastral Arë dhe Pentorë.



FOTOGRAFI E PLOTËS

Kufizimet e Pas. 77 Sht. 6.1 ha
 Vert..... Pas nr - 81
 Lindje..... Pas nr - 81, 122
 Jug..... Pas nr - 118, 122
 Perëndim..... Pas nr - 118

SHPJETOJA:
 Pas. 77 shi me Shërbëtorë 6.1 ha dyshë e ish Nënkomandantit Bujëbuzare

1. X-475040.5	2. X-475070.1	3. X-475043.9	4. X-476648.4	5. X-475938.8	6. X-475074.2
Y-4512389.7	Y-4522000.3	Y-4523154.2	Y-4523104.8	Y-4523109.9	Y-4512720.5

PLAN GJENERAL DOKUMENT



